

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Kaçanik shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Ekonomisë
Institucioni	Komuna Kaçanik
Nr. i Referencës	RN00008670
Kodi	RPC0002447
Data e njoftimit	22.03.2022
Afati për aplikim	12.04.2022 - 26.04.2022

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- i. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- ii. Zhvillon aktivitetet rreth përgatitjes dhe hartimit të planeve të zhvillimit global strategjik të komunës për periudha të caktuara afatgjate dhe afatshkurtër ;
- iii. Krijon parakushtet për nxitjen dhe përmirësimin e ambientit afarist lokal dhe këshillon përfaqësuesit e bizneseve locale për qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në financa përmes ndërmjetësimit në mes të institucioneve financiare vendore dhe ndërkombëtare dhe bizneseve të ndryshme lokale;
- iv. Harton analizat e kostove përfituese për projektet e mëdha të investimeve publike (pip dhe cba) si dhe bënë analizat për projektet konkrete (swot-analizat) ;
- v. Koordinon aktivitetet rreth promovimit të investimeve. Komunikon me investitorët potencial dhe siguron një bashkëveprim të vazhdueshëm duke dhënë udhëzime dhe këshilla të ndryshme për mundësinë e angazhimit të kapitalit të tyre në veprimtaritë prodhuese dhe shërbyese.
- vi. Bashkëvepron me komunitetin e biznesit, krijon kushtet dhe mundësinë e promovimit të produkteve prodhuese dhe shërbimeve të ndërmarrjeve lokale përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në panaire të ndryshme me karakter reklamues dhe komercial, poashtu përvetëson praktikatat nga panairët tjera (tradicionale) të mallrave të ndryshme të prodhuara nga bizneset qoftë në vend apo jashtë vendit.
- vii. Merr pjesë në grupe punuese, organizimin e konferencave të ndryshme rreth zhvillimit ekonomik lokal me qëllim të përvetësimit dhe zbatimit të praktikave të reja në komunë;
- viii. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në Fakultetin Ekonomik.

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës..



- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0002244	RN00008452	Zyrtar për Zhvillim	Profesional 2	6	Komuna Kaçanik	Sektori i turizmit dhe zhvillimit ekonomik / Kaçanik

Pērmes portalit pēr rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-qov.net>)

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion
- Kopja e letërnjoftimit, ekstrakti i lindjes
- dëshminë se nuk është nën hetime
- dëshmia shëndetësore (pas përzgjedhjes)

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen